



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

APS.nr.1/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti – kryetar, Kreshnik Radoniqi dhe Burim Ademi – anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarve **SH.F., SH.A.** dhe **A.J.1.**, për shkak të veprës penale *krim i organizuar* nga neni 274 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, e lidhur me veprën penale *keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 par. 1 KPRK-së dhe veprës penale *shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve* nga neni 92 i Kodit Doganor të Kosovës, ndërsa ndaj të akuzuarve **M.V., M.M., B.F., F.T., A.T.** dhe **A.J.2.** për shkak të veprës penale *krim i organizuar* nga neni 274 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, e lidhur me veprën penale *shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve* nga neni 92 i Kodit Doganor të Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve – të akuzuarës SH.A., avokat Leon Përlaska, të akuzuarit A.J.1., avokat Ramiz Krasniqi, të akuzuarit M.V., avokat Florin Vërtopi, të akuzuarit M.M., avokat Mentor Neziri, të akuzuarit A.T., avokat Arlind Jupolli, të akuzuarit B.F., avokat Agron Curri, të akuzuarit A.J.2., avokat Asdren Bytyqi, dhe përgjigjen në ankesën e Prokurorisë të akuzuarit F.T., avokat Aziz Rexha, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda P.nr.445/08 të datës 11.03.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.12.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve dhe sipas detyrës zyrtare, **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda P.nr.445/08 të datës 11.03.2019 dhe çështja kthehet në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin P.nr.445/08 të datës 11.03.2019, ka shpallur fajtor të akuzuarit – **SH.F., SH.A.** dhe **A.J.1.**, për veprë penale *krim i organizuar* nga neni 274 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, e lidhur me veprën penale *keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 par. 1 KPRK-së dhe veprës penale *shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve* nga neni 92 i Kodit Doganor të Kosovës, ndërsa ndaj të akuzuarve **M.V., M.M., B.F., F.T., A.T.** dhe **A.J.2.** për veprë penale *krim i organizuar* nga neni 274 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, e lidhur me veprën penale *shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve* nga neni 92 i Kodit Doganor të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka gjykuar me dënim të kushtëzuar si në vijim:

- Të akuzuarin SH.F. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 5 (pesë) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin A.J.1. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 5 (pesë) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 10.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin SH.A. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 4 (katër) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin B.F. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 4 (katër) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin A.T. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 4 (katër) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin M.V. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të

revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

- Të akuzuarin M.M. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin A.J.2. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 09.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- Të akuzuarin F.T. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.10.2007 deri me 08.07.2008 i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarve ka shqiptuar edhe dënimin plotësues – konfiskimin e sendeve, si në vijim:

Të akuzuarit SH.F. i ka konfiskuar:

- Një set me ngjyrë të zezë me çelës me shumën e të hollave prej 4.179 euro,
- Automjeti i udhëtarëve i markës “Audi 8E” (AUDI A4), me ngjyrë hiri metalike me nr. shasisë WAUZZ8E52A147944, viti i prodhimit 2002, me tabela regjistrimit,
- Leja qarkullimit për automjetin e lartpërmendur,
- Një vulë e falsifikuar CZECH PX me përmbajtje “FINISH PX DANISH CAMPS SUPPLY ApS”,
- Një vulë e falsifikuar e PX Finlandez me përmbajtje “FINISH PX DANISH CAMP SUPPLY ApS,
- Automjet i udhëtarëve “BMW 6L”, ngjyrë e kuqe e mbyllët me nr. shasisë VBAAL710X 0KE57907, viti i prodhimit 1999, me tabela të regjistrimit,
- Automjeti i udhëtarëve “Renault Twingo”, ngjyrë e gjelbër metalike, viti i prodhimit 2005, me nr. shasisë VF1C066M120163662, me tabela të regjistrimit,
- Shumën e të hollave prej 20.055,58 euro, të ngrira në llogarinë bankare Raiffeisen Bank:

Të akuzuarës SH.A. i janë konfiskuar:

- Shuma e të hollave prej 5.086,75 euro, të ngrira në llogarinë bankare Raiffeisen Bank:

Të akuzuarit A.J.1. i janë konfiskuar:

- Automjeti “BMW” xhip, ngjyrë e zezë metalike, nr. shasisë WBAFB71090LW39730, viti i prodhimit 2004, me tabela të regjistrimit,
- Automjeti “Daimler Chrysler” D210, ngjyrë e zezë metalike, nr. shasisë WDB2100261A984951, viti i prodhimit 1999, me tabela të regjistrimit

Të akuzuarit M.V. i janë konfiskuar:

- Shuma e të hollave prej 231,00 euro, të ngrira në llogarinë bankare të Raiffeisen Bank:,
- Automjeti i udhëtarëve “Volkswagen” 1 J Bora, ngjyrë hiri metalike, me nr. shasisë WVWZZZ1JZYW110553, viti i prodhimit 1999, me tabela të regjistrimit

Të akuzuarit M.M. i janë konfiskuar:

- Shuma e të hollave prej 1.409,00 euro, të ngrira në llogarinë bankare të Raiffeisen Bank:

Të akuzuarit B.F. i janë konfiskuar:

- Automjeti i udhëtarëve “Audi B5”, ngjyrë e zezë, me nr. shasisë WAUZZZ8DZXA027997, viti i prodhimit 1998, me tabela të regjistrimit

Të akuzuarit A.T. i janë konfiskuar:

- Automjeti i markës “Volkswagen” kombi furgon me nr. shasisë VVV2ZZZ70ZNH115019, me tabela të regjistrimit,
- Libreza e qarkullimit VRD0673194, me tabela të regjistrimit,
- Automjeti i markës “Mercedes-Daimler Chrysler” kombi, me nr. shasisë WDB9026611R333939,
- Libreza e qarkullimit VRD0645026 me tabela të regjistrimit,
- Automjet “Volkswagen” CADDY SDI (pickup), ngjyrë e bardhë, me nr. shasisë WV1ZZZ9KZTR504239, viti i prodhimit 1996, me tabela të regjistrimit,
- Automjet transporti “Voklswagen” 70D, me nr. shasisë WV2ZZZ70ZNH115019, ngjyrë e verdhë, viti i prodhimit 1992.

Të akuzuarit A.J.2. i janë konfiskuar:

- Shuma e të hollave prej 50.000,00 euro, të ngrira në llogarinë bankare të ProCredit Bank,
- Shuma e të hollave prej 60.400,00 euro, të ngrira në llogarinë bankare të ProCredit Bank,
- Shuma e të hollave prej 586.50,00 euro, të ngrira në llogarinë bankare të Raiffeisen Bank,
- Automjeti i udhëtarëve “Renault Clio”, ngjyrë hiri metalike, me nr. shasisë WF1BB020A20741894, viti i prodhimit 1999, me tabela të regjistrimit

E dëmtuara Doganat e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 200 (dyqind) euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e saj dhe të akuzuarve t’iu shqiptoj dënime me burgim.
- Mbrojtësi i të akuzuarës SH.A., avokat Leon Përlaska, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për konfiskim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe e akuzuara të lirohet nga akuza.
- Mbrojtësi i të akuzuarit A.J.1., avokat Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit të gabuar për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.
- Mbrojtësi i të akuzuarit M.V., avokat Florin Vërtopi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal dhe konfiskimin e dobisë pasurore, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, si dhe të anulohet vendimi për sendet e konfiskuara.
- Mbrojtësi i të akuzuarit M.2. Mustafa, avokat Mentor Neziri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose çështja të kthehet në rigjykim.
- Mbrojtësi i të akuzuarit A.T., avokat Arlind Jupolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuarit të lirohet nga akuza.
- Mbrojtësi i të akuzuarit B.F., avokat Agron Curri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose çështja të kthehet në rigjykim.

- Mbrojtësi i të akuzuarit A.J.2., avokat Asdren Bytyqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose çështja të kthehet në rigjykim.
- Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit F.T., avokat Aziz Rexha, me propozim që ankesa e Prokurorisë të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.348/19 të datës 25.07.2019, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime me burgim, ndërsa të refuzohen ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, në të cilën ishin të pranishëm të akuzuarit A.J.1. dhe mbrojtësi i tij avokati Ramiz Krasniqi, i akuzuari M.V. dhe mbrojtësi i tij avokati Florin Vërtopi, i akuzuari M.2. M. dhe mbrojtësi i tij avokat Mentor Neziri, i akuzuari A.J.2. dhe mbrojtësi i tij avokat Asdren Bytyqi, mbrojtësi i të akuzuarës SH.A. avokat Leon Përlaska, mbrojtësi i të akuzuarit B.F. avokat Agron Curri, mbrojtësi i të akuzuarit A.T. avokat Arlind Jupolli, dhe mbrojtësi i të akuzuarit F.T. avokat Aziz Rexha. Në seancën e kolegjit kanë munguar përfaqësuesi i Prokurorisë së Apelit, të akuzuarit SH.F., SH.A., B.F., F.T. dhe A.T. edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt. Gjatë seancës mbrojtësit e të akuzuarve mbetën pranë pretendimeve të parashtruara me shkrim, si dhe të akuzuarit prezent mbështeten mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara.

Pretendimet Ankimore

Ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Prokuroria Speciale në ankesën e saj pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është tejet i butë dhe në disproporcion të thellë me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve. Për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit parashihet dënimi prej së paku 5 vite burgim dhe nuk mund të justifikohet dënimi i shqiptuar të akuzuarve nën minimumin ligjor edhe me aplikimin e dispozitave të zbutjes së dënimit, sepse sipas nenit 52 par. 1 të KPRK-së, dënimi me kusht

lejohe vetëm për vepra penale të dënueshme deri në 5 vite burgim, andaj në rastin konkret në asnjë mënyrë nuk lejohet shqiptimi i dënimit me kusht. Sipas prokurorisë Gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar rrethanat rënduese si peshën e veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale, e veçmas lartësinë e dëmit të shkaktuar ndaj buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 2,411,927,71 euro. Andaj, i propozon Gjykatës së Apelit që të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarve t’iu shqiptoj dënim me burgim më të lartë dhe efektiv sipas ligjit.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarës SH.A.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarës SH.A., avokatit Leon Përlaska theksohet se aktgjykimi i ankimuar është i paqartë dhe kontradiktor në vetvete. Në përshkrimin e veprës duhet të shënohen veprimet e secilit të akuzuar, koha e kryerjes, vendi i kryerjes, objektin në të cilin është kryer vepra, mjetin me të cilin është kryer si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale. Lidhur me të akuzuarën Sh. kemi vetëm një fjali si “përmes SH.A. menaxhere në BDF” dhe asnjë veprim tjetër nuk përmendet. Atëherë cilat janë veprimet e të akuzuarës të përshkruara me fjalën “përmes”. Mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të procedurës penale pasi që e ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes që të bëhet ekspertiza e re financiare, pasi që mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia që të ballafaqojnë ekspertin, pasi që eksperti i cili ka kryer ekspertizën ka vdekur. Mbrojtja gjithashtu pretendon se kemi të bëjmë me vepra të parashkruara penale pasi që për dy veprat bazë ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale dhe se tani nuk mund të akuzohen për krim të organizuar pasi që nuk mund të ekzistoj pa veprën bazë. Pretendohet se e akuzuara nuk ka pas lidhje me mallin sepse ajo ka pas kontratë me SH.F.n dhe ka qenë e detyruar ti përmbush detyrat e punës, por që puna e saj nuk ka pas fare të bëjë me BDF Distribution. Malli që ka arrit ka qenë në i bllobuar në kamion që të drejtë hapjes kanë pas vetëm ushtarët e KFOR-it dhe e akuzuara nuk e ka pa mallin. Kjo është vërtetuar edhe nga dëshmitarja V.P. zyrtare e doganës e cila deklaroi se malli ka shkuar në depon e veçantë në Sllatinë, në bazën ushtarake të KFOR-it. I akuzuari SH.F. kishte deklaruar se e akuzuara Sh. nuk kishte përgjegjësi për nxjerrjen e mallit nga depoja e BDF Distribution. Gjithashtu kishte thënë se ajo ka kryer punën e përditshme dhe nuk kishte qenë në dijeni se çka po ndodh. Lidhur me konfiskimin mbrojtja thekson se propozimi për konfiskim nuk ka qenë i përfshirë në aktakuzë, vendimi për konfiskim nuk mbështetet në asnjë provë dhe se janë konfiskuar sendet për të cilat nuk ka pas urdhër për ngrirje. Andaj, i propozon Gjykatës së Apelit që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe e akuzuara SH.A. të lirohet nga akuza.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.J.1.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.J.1., avokat Ramiz Krasniqi, pretendohet se as koha e as mënyra e kryerjes së veprës penale nuk dihen. Nga dispozitivi nuk mund të kuptohet se kur fillon njëra vepër e kur përfundon tjetra. Sipas aktgjykimit të akuzuarit Arben i janë konfiskuar palujtshmëritë dhe atë dy vetura, por që nuk janë paluajtshmeri. Megjithatë, të akuzuarit asnjëherë në asnjë rast nuk i janë konfiskuar këto vetura. Në ankesë pretendohet se i akuzuari A.

asnjëherë nuk ka pas ndonjë pozitë menaxheriale në ICE BEAR PX, ngase menaxher ishte një shtetas Danez. Cigaret e gjetura në shtëpinë e të akuzuarit nuk kanë asgjë të bëjë me babain e tij, të akuzuarin A.J.2.. Cigaret ishin në shtëpi të tij përkohësisht, jo për tu keqpërdorur por që të nesërmen të dorëzohen në shitoren ku ka punuar i akuzuari, për të cilën e ka ditur edhe pronari Danez. Mbrojtja pretendon se i akuzuari A.J.1. nuk e ka pas cilësinë e personit zyrtar, sepse i njëjti as nuk është zgjedhur as emëruar, por ka qenë thjeshtë një shitës dhe nuk është varur asnjë vendim nga ai. Andaj, propozon që të akuzuarin A.J.1. ta liroj nga aktakuza.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.V.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.V., avokatit Florin Vërtopi, pretendohet se kemi të bëjmë me parashkrimin e veprës bazë dhe se vepra bazë është element përbërës i veprës penale të krimit të organizuar. Në këtë drejtim meqenëse vepra bazë është parashkruar atëherë nuk ekziston vepra e krimit të organizuar për shkak se i mungon elementi kryesor i veprës. Më tej në ankesë pretendohet se aktakuza nuk përmban elementet e nevojshme për trajtimin e çështjes që lidhen me kualifikimin juridik, objektin, vendin dhe mjetin e kryerjes së veprës penale, dhe sa aktakuza ka dështuar që të argumentoj përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M.V. ka kryer veprën penale. Sipas ankesës mungon lidhja kauzale në mes veprimit me dashje të akuzuarit M.1. dhe pasojës së krijuar, e kjo nuk ka mund të vërtetohet gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me veprën e krimit të organizuar, e për më tepër në këtë çështje nuk ka as palë të dëmtuar. I akuzuari M.V. ka qenë vetëm punëtor në depo nga e cila nuk është konfiskuar asgjë, ndërsa në bankë kishte vetëm 231 euro. Mbrojtja nuk ka pas mundësi ta kundërshtoj ekspertizën financiare pasi që eksperti kishte ndërruar jetë, ndërsa trupi gjykues ka refuzuar kërkesën për caktimin e ekspertit të ri dhe me këtë mbrojtjes i është shkelur e drejta e kundërshtimit të provës. Edhe përgjimet që janë bërë, asnjëra nuk mund të ndërlidh të akuzuarit M.1. me veprën e kryer. I akuzuari M.1. ishte punëtor i firmës Pimi Tobacco dhe me leje të pronarit ka shitur klientëve vetëm cigare me banderola. Sa i përket konfiskimit të akuzuarit M.1. i janë konfiskuar 231 euro të ngrira në llogari në Raiffeisen Bank dhe automjeti Volkswagen 1 J Bora, por që nuk është argumentuar me asnjë provë që i akuzuari është kryes i veprës penale që të konfiskohen këto sende. Në atë kohë as nuk ishin ngrirë këto mjete dhe se nuk kishte masë të përkohshme, por vetëm zbulim i të dhënave financiare, ndërsa vetura asnjë herë nuk është sekuestruar, dhe pastaj është tjetërsuar për një vlerë shumë të vogël, e për më tepër prokurori i shtetit në seancën e datës 26.02.2019 ka heq dorë nga konfiskimi i këtyre sendeve. Andaj, Gjykatës së Apelit i propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.2. Mustafa

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.2. Mustafa, avokatit Mentor Neziri, thekson se aktgjykimi i ankimuar ka dështuar të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse, e sidomos në raport me të akuzuarin M.2. M.. Thekson se edhe përkundër që prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga konfiskimi i sendeve

për të gjithë të akuzuarit që kanë deklaruar se nuk iu kanë konfiskuar sendet, ndërsa të akuzuarit M.2. nuk i është konfiskuar asgjë gjatë bastisjeve, gjykata e shkallës së parë megjithatë i konfiskon parat në shumë prej 1.409,00 euro të ngrira në llogari në Raiffeisen Bank. Sipas aktgjykimit të ankimuar theksohet se i akuzuari M.2. në mënyrë kontinuele ka blerë cigare pa banderola nga i akuzuari A.J.1., por kjo me asnjë provë nuk është vërtetuar. Përgjimet telefonike nuk vërtetojnë asnjë lidhje me të akuzuarin M.2., telefonatat i kishte vetëm me të akuzuarin M.V. i cili kishte punuar për të. As SMS-ët e nxjerra nuk tregojnë ndonjë lidhje me veprat penale. Ekspertiza financiare që është administruar plotësisht mbështet pretendimin e të akuzuarit se nuk ka lidhje me veprat penale. Nga ekspertiza rezulton se nuk ka pas asnjë faturë në emër të firmës së të akuzuarit M.2. – Pimi Tobacco, edhe nga raportet e bastisjeve konstatohet se nuk i është gjetur asgjë e kundërligjshme të akuzuarit. Gjithashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve në asnjë pjesë të deklarimeve të tyre nuk inkriminohet i akuzuari M.2.. Andaj, i propozon Gjykatës së Apelit që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin M.2. Mustafa ta liroj nga akuza, apo të njëjtën ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.T.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.T., avokatit Arlind Jupolli theksohet se me asnjë provë nuk është dëshmuar vepra penale e krimit të organizuar sepse duhet të përmbushen kushtet si të ketë grup të strukturuar nga 3 e më shumë persona në mes të cilëve duhet të ekzistoj marrëveshje, të ekzistoj veprimi i të pandehurit duke e ditur qëllimin, dhe që aktivisht të merr pjesë në aktivitet kriminal të grupit. Asnjëra nga këto nuk manifestohet tek i akuzuarit A.T., sepse ai nuk e njeh asnjërin nga të akuzuarit përveç vëllait tij F.T., nuk i takon asnjë grupi, nuk ka ndonjë marrëveshje me askënd, nuk ka ndërmarr asnjë veprim të qëllimshëm dhe po ashtu nuk është vërtetuar se ka marr pjesë në aktivitete kriminale të ndonjë grupi. Asnjë provë nuk dëshmon se i akuzuari Arsim ka ndonjë lidhje me veprat, as dëshmitarët nuk e kanë përmendur, e sidomos dëshmitarja V.P. si zyrtare e doganës nuk e përmend fare të akuzuarin A.. Në ankesë po ashtu pretendohet se ka arrit parashkrimi absolut i veprës bazë dhe për këtë nuk mund të ekzistoj edhe vepra e krimit të organizuar, për çka gjykata e shkallës së parë është dashur që të përkujdeset zyrtarisht. Gjithashtu thekson se është e padrejtë që të ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor për arsye se i akuzuari A. nuk e ka kryer veprën penale. Andaj, propozon që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe i akuzuari A.T. të lirohet nga akuza.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.F.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.F., avokatit Agron Curri, theksohet se aktgjykimin është i paqartë, në kundërshtim me pjesën e arsyetimit, sepse nuk shpjegohet në mënyrë bindëse se cilat ish-in provat vendimtare sipas të cilave është shpallur fajtor i akuzuari B.F., duke pas parasysh se asnjëra provë që është administruar e asnjëri dëshmitar nuk e përfshijnë të akuzuarin Besnik. Sipas mbrojtjes, aktgjykimin i ankimuar thekson se i akuzuari B.F. është vëllai i SH.F.t dhe ka punuar në ngarkim e shkarkim në depon ushtarake në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe

se roli i tij ka qenë sigurimi i blerësve dhe kujdesi që pa u hetuar malli-cigaret të largohen nga depoja ushtarake, por që kjo nuk është mbështetur me asnjë provë, nuk ka asnjë shpjegim se në bazë të cilës dëshmi është provuar kjo rrethanë. Sipas mbrojtjes nuk ka mund të vërtetohet me asnjë provë se B.F. ka pas ndonjë rol apo që në veprimet e tij janë formuar dhe qëndrojnë elementet e veprës penale të krimit të organizuar dhe shmangies nga pagesa e detyrimeve doganore. Gjithashtu pretendohet se konfiskimi i veturës Audi B5 nga i akuzuari është bërë pa u vërtetuar faktet vendimtare për këtë çështje. Andaj, propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.J.2.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.J.2., avokatit Asdern Bytyqi, theksohet se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare për të cila ka kundërthënë të konsiderueshme. Provat që janë administruar në nuk tregojnë se autor i veprave penale është i akuzuari A.J.2.. Gjykata e shkallës së parë transkriptet telefonike i merr si prova fajësuese për të akuzuarin A.2., pas pasur prova tjera që mbështesin përgjimet. Nga provat e administruara nuk ka mund të vërtetohet se cilat ishin veprimet konkrete të akuzuarit A.2. në grup dhe si bashkezekutor. Mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marr parasysh fare provat që i kanë prezantuar që pafajësinë e të akuzuarit e gjithashtu në aktgjykim nuk janë dhënë asnjë arsyetim se ku konsistojnë elementet e veprës penale për të cilën e ka shpall fajtor të akuzuarin. Kjo për faktin se mungon ana objektive dhe nuk është provuar dashja e të akuzuarit në kryerjen e veprime për qëllim të përfitimit material. Provat që janë marr si inkriminuese për të akuzuarin A.2. janë supozime për shkak se në përgjimet fjala që është përdorur “H...” iu është referuar të akuzuarit A.2., por kjo nuk mund të supozohet kur asnjëri dëshmitar që është dëgjuar në asnjë mënyrë nuk e implikojnë të akuzuarin A.2. e as që e kanë njohur, e po ashtu as nuk është i ndërlidhur në ekspertizën financiare. Cigaret që janë konfiskuar nga shtëpia e të akuzuarit A.2. nuk kanë qenë të tij por të birit tij A.J.1.t i cili ka pranuar që cigaret kanë qenë të tij. Mbrojtja pretendon se nuk mund të shpallet fajtor i akuzuari në bazë të supozimeve, e për më tepër aktgjykimi i ankimuar nuk ka arrit të arsyetoj fajësinë e të akuzuarit. Andaj, i propozon gjykatës së apelit që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ta liroj të akuzuarin apo aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Përgjigja në ankesën e Prokurorisë nga mbrojtësi i të akuzuarit F.T.

Në përgjigjen në ankesën e prokurorisë të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit F.T., avokat Aziz Rexha, theksohet se ankesa e prokurorisë është e pabazuar për shkak se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari F., sepse me rastin e bastisjes në shtëpinë e tij dhe lokalin ku punon nuk është gjetur asnjë pako cigare pa banderola, dhe për këtë arsye nuk i është konfiskuar asgjë sepse nuk ka pas çka të konfiskohet. Andaj, konsideron se nuk është vërtetuar gjendja faktike si në aktgjykimin e ankimuar, në fakt është vërtetuar gabimisht. Thekson se për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore nuk ka parashtruar ankesë, por i propozon gjykatës së

apelit që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe të kthehet në rigjykim, eventualisht të vërtetohet aktgjykimi.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve në bazë të nenit 394 par. 1 të KPRK-së, e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 dhe par. 2 nën par. 2.2 të KPPRK-së, të cilat kushtëzojnë anulimin e saj, pasi që aktgjykimi nuk është i përpiluar në kuptim të nenit 370 të KPPRK-së, ashtu që mbrojtjes i është pamundësuar mbrojtja efektive si dhe janë aplikuar gabimisht dispozitat e ligjit penal lidhur me veprat penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor.

Sipas aktgjykimit të ankimuar rezulton se të akuzuarit SH.F., SH.A. dhe A.J.1. janë shpallur fajtorë për veprë penale të krimit të organizuar nga neni 274 par.2 lidhur me par. 1 të KPK-së, pra sipas ligjit në fuqi nga viti 2004 gjer në vitin 2013, ndërlidhur me veprën penale *keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, sipas ligjit në fuqi nga 2013 gjer në prill 2019, dhe veprës penale *shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve* nga neni 92 i Kodit Doganor të Kosovës si ligj i veçantë.

Lidhur me aplikimin e dy kodeve penale për një përshkrim të gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk jep shpjegime. Nëse nisemi prej parimit të aplikimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin, atëherë vepra penale e krimit të organizuar sipas kodit të vjetër rezulton se është më i favorshëm, për shkak se dispozita e paragrafit 2 e nenit 274 parasheh dënim me së paku 5 vite burgim, ndërsa ligji i ri për këtë veprë penale parasheh dënim me gjobë dhe me burgim së paku 7 vite. Por, shtrohet pyetja pse është aplikuar vepra penale e *keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 të KPRK-së, kur dënueshmëria varet prej veprës së krimit të organizuar, e jo veprës bazë e cila pretendohet se është kryer në kuadër të krimit të organizuar. Por, në anën tjetër edhe definicioni i “personit zyrtar” duhet të shikohet sipas ligjit më të favorshëm. Në aktgjykimin e ankimuar shpjegohet se pse parashkrimi nuk arrihet për veprat bazë, për shkak se janë ndërlidhur me veprën e krimit të organizuar, çka edhe Gjykata e Apelit pajtohet. Por, Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje të ligjit penal duke i aplikuar dispozitat e dy kodeve të ndryshme për një përshkrim faktik, çka paralelizmi ligjor nuk lejohet.

Lidhur me gjetjet se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata e shkallës së parë nuk jep shpjegim lidhur me ekzistimin e grupit të strukturuar kriminal. Sipas Kodi Penal të vitit 2004, por edhe sipas kodeve tjera pasuese, që të ekzistoj vepra penale e

krimit të organizuar, duhet të vërtetohet ekzistimi i grupit të strukturuar¹ për të kryer vepra penale. Nga aktgjykimi i ankimuar mund të nxirren konkludime tejet të përgjithshme se të akuzuarit kanë qenë pjesë e një skeme të organizuar, thuhet se të gjithë të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm se i përkasin grupit të organizuar, theksohet se nuk është e nevojshme që të akuzuarit të njohin njëri tjetrin që të kontribuojnë në krim të organizuar, por e gjithë kjo pa shpjeguar se cilat prova i vërtetojnë këto konstatime dhe se vetëm janë përgjithësuar. Gjykata e Apelit gjen se duhet të vërtetohet pjesëmarrja aktive e kryesve në aktivitetin kriminal të grupit të strukturuar që me dijeni pjesëmarrja e tyre do të kontribuoj kryerjes së veprës, përmes së cilës edhe do të ketë përfitim material. Për më tepër duhet të vërtetohet se kush është udhëheqësi i grupit apo së paku që i tërë grupi të ketë pas aktivitete kriminale si pjesëmarrës në dobi të grupit të strukturuar kriminal i cili e ka një udhëheqës. Nga përshkrimi i gjendjes faktike nuk rezulton të kemi ndonjë person që ka qenë udhëheqës i grupit të strukturuar.

Aktgjykimi i ankimuar nuk jep arsye se në çfarë forme të akuzuarit kanë kontribuar duke marr pjesë aktivisht në aktivitete kriminale apo aktivitete tjera të grupit të strukturuar. Në njërin pjesë të aktgjykimit për të akuzuarin M.2. i cili ishte pronar i një depo/firme, theksohet “...sigurisht i akuzuari M.2. ka qenë në dijeni dhe se veprimet e tij inkriminuese si pjesë e grupit i ka kryer përmes të akuzuarit M.V.”. Nga kjo shihet se edhe gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë plotësisht e bindur për të vërtetuar veprimet e të akuzuarit M.2., sepse nuk i referohet provës e cila e vërteton veprimin, por flet për probabilitetin e dijenisë së të akuzuarit. Theksohet se i akuzuari M.2. ka vepruar përmes të akuzuarit M.1. për shkak se ky i fundit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të akuzuarit A.J.1.. Por, nuk shpjegohet në asnjë mënyrë veprimi inkriminues i të akuzuarit M.2. si pjesëmarrës aktiv në aktivitetin kriminal të grupit të strukturuar, apo si ishin veprimet e tij përmes të akuzuarit tjetër.

Nga provat e administruara rezulton se cigaret janë shitur pa banderola nga të akuzuarit SH.F., A.J.1. dhe B.F., të akuzuarve F.T., A.T., M.2. M., dhe M.V., ky i fundit si punëtor i të akuzuarit M.2., me qëllim që t’i shesin ato blerësve tjerë. Pra, cili është kontributi i këtyre personave në grupin e strukturuar kur këta kanë blerë mall me çmim më të lirë të shumicës që t’i shesin më shtrenjtë me çmim të pakicës. Nga kjo rezulton se kemi një grup të personave që e kanë shfrytëzuar biznesin me KFOR-in, duke mashtruar me hyrje fiktive të mallit në PX të KFOR-it dhe këtë mall e kanë shitur personave tjerë të cilët merreshin me shitjen e cigareve apo kishin dyqan ku në mesin e produkteve tjera shiteshin edhe cigaret. Lidhur me këto aktgjykimi i ankimuar nuk jep shpjegim se si këta persona me dijeni kanë pasur aktivitet kriminal në dobi të grupit të strukturuar kriminal, kur rezulton se të gjithë kanë punuar për përfitime për vete në aktivitet të ndaluar biznesi.

Sa i përket veprës penale *keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 të KPRK-së, Gjykata Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë nuk jep shpjegime lidhur me pozitën zyrtare

¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR.nr.1282/12 i datës 28.05.2014.

të tre të akuzuarve të parë. Andaj, në rigjykim duhet të rivlerësohen provat përsëri lidhur me ekzistimin e kësaj veprë. Me rastin e rivlerësimit duhet të vërtetohet se pozitat që kanë pasur të pandehurit SH.F., SH.A. dhe A.J.1. a konsiderohen pozita zyrtare dhe a bien nën përkufizimin e Kodit të ri Penal (Prill 2019) siç parashihet me nenin 113 paragraf 2.

Gjithashtu mbrojtjes i është pamundësuar mbrojtja efektive lidhur me dëgjimin e ekspertit financiar i cili pas përpilimit të ekspertizës kishte ndërruar jetë, ndërsa gjykata nuk ka caktuar ekspert të ri për përpilimin e ekspertizës së re në mënyrë që të mundësohet mbrojtjes kundërshtimi apo marrja në pyetje të ekspertit që të parashirojnë pretendimet e tyre lidhur me mbrojtjen. Në këtë drejtim pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve SH.A. dhe M.V. janë të bazuara.

Gjithashtu edhe me rastin e matjes së dënimit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje ligjore duke mos shqiptuar dënime në përputhje me ligjin. Vepra penale e *krimin të organizuar* nga neni 274 par. 2 të KPK-së parasheh dënim me gjobë dhe me burgim së paku 5 (pesë) vite. Gjykata e shkallës së parë të akuzuarve iu ka shqiptuar dënime të kushtëzuara të gjithë të akuzuarve, duke shkelur kështu nenin 44 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës që është aplikuar (prill 2004), kjo për faktin se dënimin me kusht lejohet vetëm për vepra të dënueshme me burgim deri në 5 (pesë) vjet dhe për vepra të dënueshme me burgim deri në 10 (dhjetë) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit. Në rastin konkret dënimi për krim të organizuar parashihet me burgim të paktën 5 (pesë) vjet, ndërsa sipas dispozitës së përgjithshme të nenit 38 par. 1 të KPK-së, dënimi me burgim nuk mund të jepet më shumë se 20 (njëzetë) vjet. Pra, edhe me zbatimin e dispozitave të zbutjes, nuk mund të shqiptohet dënim me kusht. Gjithashtu, nuk është aplikuar edhe dënimi komulativ – dënimi me gjobë që është i obligueshëm për veprën penale të krimin të organizuar, sepse parasheh dënim me gjobë dhe me burgim.

Po ashtu edhe lidhur me konfiskimin e sendeve siç janë theksuar më lartë, gjykata bazohet në raportin e policisë DKKO/NJHF/35/08 të datës 13.03.2008, dhe konstaton se të akuzuarit nuk kanë pasur të ardhura tjera dhe për këtë arsye parat e fituara në periudhën e kryerjes së veprës penale sipas aktakuzës janë para të fituara kundërligjshëm dhe duhet të konfiskohen, gjithashtu edhe veturat që janë konfiskuar janë sipas raportit janë blerë në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale. Por, kjo nuk është e mjaftueshme ngase vetëm fakti që janë blerë në atë kohë dhe se parat kanë hyrë në bankë në atë kohë të konsiderohen se janë përfituar kundërligjshëm. Raporti i policisë nuk përcakton prejardhjen e pasurisë, por vetë konstaton se të akuzuarit sa para kanë në banka, cilat vetura i kanë në pronësi, paluajtshmëritë që i kanë në pronësi dhe kohën e përfitimit. Gjykata këtë duhet ta vërtetojë me prova se të ardhurat janë të ardhura nga krimi, se përmes këtyre të ardhurave të akuzuarit kanë kryer transaksione duke blerë vetura dhe paluajtshmëri të cilat i nënshtrohen konfiskimit, apo edhe konstatimit se për disa të akuzuar parat e konfiskuara në bankë a janë para nga paga ku kanë punuar apo të përfituara në mënyrë të kundërligjshme.

Andaj, në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura dhe ti eliminoj shkeljet e evidentuara, duhet t'i administroj dhe rivlerësoj provat, dhe të vërtetojë ekzistimin e grupit të strukturuar kriminal, të vërtetoj se a kemi të bëjmë me vepër penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar apo në veprimet e të akuzuarve manifestohen elementet e ndonjë vepre tjetër penale, të aplikohet kodi adekuat penal për të akuzuarit duke u respektuar parimi i ligjit më të favorshëm apo ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprave, në rast të vërtetimit të veprave penale sipas aktakuzës të aplikoj dënimet e parapara me ligj dhe të vërtetoj se sendet e konfiskuara a janë të ardhura të krimit apo jo.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 402 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.1/2019 me datë 18.12.2019

Procesmbajtës

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Kreshnik Radoniqi

Vaton Durguti

Burim Ademi